



Pranuar / Dorezuar Primijseno/Prodato Received/Delivered	07.02.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	1527/2023		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1269/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1269/2022 të datës 27.12.2022 e parashtruar nga ankuesja Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03/02/2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1269/2022 e datës 27.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Pejës, më datë 27.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8449/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për njohje të së drejtës për harmonizim të koeficientit të pagës nga koeficienti pesë (5) në koeficientin gjashtë (6).

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankueses kanë për objekt çështjen e realizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hy në fuqi nga data 05.02.2023. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.



Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar se gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1269/2022, datë 03/02/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

